

Kushtet dhe Afatet specifike të përdorimit të “Krijo paketën tënde”

Këto Kushte dhe Afate përbëjnë të gjithë Marrëveshjen ndërmjet Jush, Klienti i Vodafone dhe Vodafone Albania Sh.A (Vodafone ose Ne, VFAL përkatësisht) në lidhje me përdorimin e “Krijo paketën tënde”. Vodafone Albania Sh.A është një shoqëri aksionerë e themeluar me vendim të Gjykatës së Rrëthit Gjyqësor Tiranë Nr. 25766, datë 10 Maj 2001, me seli në: Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. “Pavarësia”, Nr. 61, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me Nipt: K11715005L.

Përzgjedhja e paketave të personalizuar dhe blerja e tyre mund të bëhet vetëm sipas kushteve specifike të mëposhtme në dyqanet e Vodafone Albania dhe nëpërmjet aplikacionit MyVodafone.

1. “Krijo paketën tënde” ju jep mundësinë të krijoni paketën që i përshtatet nevojave tuaja, duke zgjedhur deri në 1 produkt për 4 kategori të ndryshme. Nuk ka kufizim në numrin e aktivizimeve/paketave që mund të blini.
2. “Krijo paketën tënde” është i vlefshëm vetëm për klientët me parapagesë të planit tarifor “Vodafone Club”.
3. Çmimet e lartpërmendura përfshijnë TVSH.
4. Paketat janë të vlefshme për 30 ditë nga momenti i aktivizimit.
5. Minutat kombëtare janë të vlefshme drejt të gjithë numrave Vodafone, Telecom Albania, ALBTelekom.
6. SMS kombëtare nën kategorinë “SMS” janë të vlefshme drejt të gjitha destinacioneve kombëtare (Vodafone, Telecom Albania dhe ALBTelekom).
7. SMS ndërkombëtare nën kategorinë “SMS” janë të vlefshme drejt të gjitha destinacioneve ndërkombëtare (përveç destinacioneve satelitore).
8. Klientët nuk mund të blejnë të njëjtën paketë pa konsumuar paketën ekzistuese. Gjithsesi, ata mund të blejnë një paketë tjetër në të njëjtën kategori.
9. Nëse klienti ka një paketë standarte 30 ditore dhe tenton të blejë 2 GB ose 4 GB atëherë ai mund t’i blejë këto produkte me këto cmime:
2 GB = 300 Leke me TVSH;
4GB = 500 Leke me TVSH.
10. Paketat e integruara javore dhe paketa ditore do të kenë prioritet në konsumim ndaj këtyre paketave.
11. Paketat e aktivizuara nga “Krijo paketën tënde” kanë prioritet në konsumim ndaj paketave standarte 30 ditore.
12. Kontrolli i balances mund të bëhet duke dërguar një text bosh tek 131 ose nga aplikacioni My Vodafone.
13. Pas konsumit të minutave, SMS-ve si dhe paketave të internetit ju do të tarifoheni me tarifatat standarte të Vodafone Club.
14. Për telefonatat kombëtare koha e tarifuar e bisedës është çdo 60 sekonda.
15. Tarifimi i internetit bëhet me intervale çdo 10 KB.
16. Paketat e blera nga “Krijo paketën tënde” nuk janë të vlefshme në roaming.
17. Paketat në “Krijo paketën tënde” mund të blihen vetëm në dyqanet Vodafone ose nëpërmjet aplikacionit My Vodafone.

Kushtet dhe Afatet e mësipërme mund të jenë objekt i rishikimit në çdo kohë nga Vodafone Albania Sh.A. Ju do të njoftoheni brenda një afati të arsyeshëm lidhur me këto ndryshime. Për informacion të detajuar vizitoni faqen zyrtare të Vodafone Albania, dyqanet Vodafone, apo kontaktoni pa pagesë Shërbimin e Kujdesit ndaj Klientit në 140.